



14/10
30.10.25
KBL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr.6, datë 23.10.2025

PËR

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES PËR “KËRKESËN PËR LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME TË
TJERA, TË SUBJEKTIT “BREMA AMBIENTE” SH.P.K”, ME
VENDNDODHJE: PARKU INDUSTRIAL I RRASHBULLIT,
BASHKIA DURRËS.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, vendimit nr 6, datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujqor “ të Këshillit Kombëtar të Ujqit, neni 20 gërma “c”, pas shqyrtimit të kërkesës , Këshilli Basenit Lumor Erzen,

V E N D O S I:

1. Shtyrjen e vendimarrjes për shqyrtim të mëvonshëm për “kërkesën për leje për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për qëllime të tjera të subjektit “**Brema Ambiente**” shpk me vendodhje parku industrial i Rrashbullit,bashkia Durrës, për arsyt e mëposhtme:
 - Analizat e burimit ujqor duhet të kryhen nga institucion shtetëror, përkatësisht Instituti i Shëndetit Publik
 - Të ngrihet një grup monitorimi me përfaqësues të Këshillit të Basenit Lumor Erzen që të monitorojë situatën në terren.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETAR
AFRIM QENDRO**

